



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 715/22
717/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: nga Kimete Gashi - Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhuani Anëtare dhe Vedat Poterqoi Antar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi e operatorëve ekonomik (GOE) "Euro construction&Ideor Construction sh.p.k ,me seli në Rahovec, si dhe ankesës së Grupit të operatorëve ekonomik "Eltoni Com sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k, me seli në Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave" me nr. të prokurimit: 632-22-9759-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal Gjakovë, me datë, 03.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohen, si të bazuara ankesat e operatoreve ekonomik Grupi i OE "Euro construction&Ideor Construction" sh.p.k,me seli në Rahovec, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29.11.2022 me numër protokolli 715/2022, si dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues Grupi i OE "Eltoni Com sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k, me seli në Gjakovë, parashtruar në OSHP me datën 09.12.2022,me numër protokolli 717/22, për aktivitetin e prokurimit: "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave" me nr. të prokurimit: 2022/632-22-9759-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Gjakovë.

II.Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 10.11.2022, për aktivitetin e prokurimit, "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave" me nr. të prokurimit: 632-22-9759-5-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal Gjakovë, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të sipër shënuar të kthehet në rivlerësim.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP-së për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. OSHP mund të ndërmarri masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

V. Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues "Euro construction&Ideor Construction" sh.p.k, me seli në Rahovec dhe ankesa e "Eltoni Com sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k, me seli në Gjakovë, refuzohen si të pabazuar iu bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Kuvendi Komunal Gjakovë, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 10.11.2022, ka publikuar Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave" me nr. të prokurimit: 2022/632-22-9759-5-2-1.

Kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues Grupi i OE "Euro construction&Ideor Construction sh.p.k me datë 15.11.2022, si vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK: 18.11.2022.

Kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues Grupi i OE "Eltoni Com sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k, me datë 15.11.2022, si vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK: 21.11.2022.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE me datën 29.11 2022 ka parashtruar ankesë në OSHP, "Grupi i OE "Euro construction&Ideor Construction". Po ashtu kundër vendimit të AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit, me datën 29.11.2022 ankesë në OSHP ka parashtruar edhe operatori ekonomik Grupi i OE "Eltoni Com sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë: Procedurë e hapur: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 363,000.00 €.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 19.12.2022 ka rekomanduar që:

- aprovohen pjesërisht ankesat e GOE "Euro construction&Ideor Construction" sh.p.k, me seli në Rahovec, si dhe ankesa
- GOE "Eltoni Com sh.p.k & PE-VLA-KU sh.p.k, me seli në Gjakovë,

- Të anulohet aktiviteti i i prokurimit B58 Njoftimi Mbi Vendimin e AK-së i datës 10.11.2022, dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Euro Construction - Ideor Construction sh.p.k-Rahovec".

Pretendimin ankimor nr. 1 –

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke marrë vendim për anulimin e OE "Euro Construction & Ideor Construction" ShPK-Rahovec me pretendimin se Ju si Grup i Operatoreve Ekonomik nuk keni prezantuar listën e stafit profesional dhe punëtorëve prej 15 veta ndaj nuk i plotëson kushtet për të u kualifikuar si ofertë e përgjegjshme.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Bazuar në faktet e pranura nga operatori ekonomik shihet se lista e stafit Ideor Construction është dorëzuar përmes dosjes dhe i ka 12 punëtorë duke i përfshirë edhe kualifikimet e nevojshme. Meqenëse OE "Euro Construction" -Rahovec nuk e ka përfshirë listën e stafit nga kompania "Euro Construction" dhe pas ankesës se bërë e ka përfshirë listën duke e argumentuar se stafi kanë qenë para datës se ofertimit me të cilën argumentohet me listat e stafit të nxjerrura nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitet 2019,2020,2021 dhe 2022.

Dëshmitë nga ATK për punëtorët e prezantuar nga OE "Euro Construction" janë dokumente të vlefshme pasi që të njëjtat tregojnë qartë gjendjen reale dhe faktike që kompania i posedon punëtorët, andaj është dashur të merret parasysh.

Kërkimi i sqarimeve shtesë në lidhje me stafin konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, nuk është bërë mirëpo me një veprim të tillë është bërë diskriminim OE "Euro Construction - Ideor Construction" shpk-Rahovec.

Neni 59.2 i LPP-së e parasheh që mund të kërkohen sqarime shtesë mbi cilindo aspekt të tenderit, e në këtë rast është dashur të kërkohen sqarime për stafin e punëtorëve.

Po ashtu ne nenin 7 të LPP së paragrafi 3 është përcaktuar qartë 3.Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.



Kontakti: +38649237574 / ideorconstruction@gmail.com
Rr. "Kroi i Bardhe" Nr. 91 / 001 Dardani, Prishtinë 10000

Lista e Stafit profesional dhe Punëtorëve

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Posta në Kompani	Ekspierenca	Moshë	Profesioni
1.	Durim Shala	Agjent - Menaxher	6 vite	31.00	Menaxher
2.	Jasmir Morina	Ing. i Ndërtimtarisë	16 vite	46.00	Ing. i Ndërtimtarisë
3.	Kushtrim Krasniqi	Ing. i Arkitekturës	12 vite	40.00	Ing. i Arkitekturës
4.	Kenzi Shala	Teknik - IT	4 vite	27.00	Teknik - IT
5.	Iger Rafraktari	Mjeshtër i Pllakave	12 vite	46.00	Mjeshtër i Pllakave
6.	Nazmi Shala	Shofer	9 vite	57.00	Shofer
7.	Kenzi Cakelli	Pasader - Motor	11 vite	50.00	Pasader - Motor
8.	Safet Krasniqi	Murator	9 vite	42.00	Murator
9.	Mihane Berisha	Juriste	3 vite	27.00	Juriste
10.	Fitore Shala	Asistente Administrative	2 vite	32.00	Asistente Administrative
11.	Dardan Berisha	Teknik	1 vit	23.00	Teknik
12.	Meriton Berisha	Pasader - Motor	1 vit	24.00	Pasader - Motor

"IDEOR CONSTRUCTION" SH.P.K.



81070995 | 805m Morina D.L. | ideorconstruction@gmail.com | ÇKQV



Administrata e Takimeve të Kosovës
Poroska Administratës Kosovë
Tax Administration of Kosovo

2022

Nr. Pë.	Emri	M.	P.	JAN	FEB	MAR	APR	MAY	JUN	JUL	AUG	SEP	OCT	NOV	DEC
1	124360019	ADAM	MORINA	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	2018813897	RIJEM	BYTYQI	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	2007219797	DEJANA	MORINA	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	1030400283	DIJAN	GASHI	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	1176308602	FLOREN	MURTAJ	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	1002078101	USJAL	MAKSH	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7	1007860363	HATI	BYTYQI	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	1007840360	KUJTIM	MORINA	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
9	1244916170	KUJTIM	MORINA	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	1243600361	HAJRI	MOTI	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
11	2007314107	HEJRALP	MOTI	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12	1233601826	RAVIRE	MORINA	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13	1172100370	SHIREND	DEJANA	PO	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14															
15															

5

100 | rrethit përfaqë

1 - 13 prej 13 rrethit

Meqenëse kompania "Euro Construction" në bashkëpunim me kompaninë "Ideor Construction" bazuar në dokumente faktike, fiktive para datës së aplikimit dëshmojnë se Grupi Operatorëve Ekonomik N.N.P. Euro Construction; Ideor Construction Sh.P.K kanë numër të mjaftueshëm të sfatit për t'u kualifikuar si Operator Ekonomik me çmim më të ulët duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosje të tenderit shoqëruar dhe informacion shtesë përmes ankesës.

AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin për pezullimin e aktivitetit të Prokurimit, ku vendos të pezullojë këtë aktivitet të prokurimit pasi lënda është në OSHP.

Pretendimi ankimor nr. 2

OE ankues pretendon se AK nuk ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim pas vendimit të AK-së për pezullimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

AK me datë 10.11.2022 ka publikuar njoftimin për shpalljen e fituesit të këtij aktiviteti të prokurimit. OE ankues me datë 15.11.2022 ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimet e njëjta ankimore si në këtë ankesë duke kundërshtuar vendimin për anulim.

AK nuk ka shqyrtuar kërkesën nga OE me datë 18.11.2022 sipas pretendimeve ankimore.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 LPP-së.

Gjithashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse ka diskriminuar OE N.N.P. "Euro Construction"& "Ideor Construction Sh.P.K", duke mos shpallur fitues edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo AK nuk ju ka përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

AK nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së, edhe kanë qenë të obliguar që të sigurohuni që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit,

AK është dashur të marr parasysh nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pretendimi ankimor nr. 3

Nga OE – AK nuk ka fluar të gjithë operatorët ekonomik për të ofruar dëshmi shtesë por në këtë rast ka bërë shkelje duke e fluar vetëm OE fitues. Me këtë ka bërë diskriminim për OE të tjerë.

Diskriminimi i Operatoreve dhe mos aplikimi i LPP-se, Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nga AK.

Përgjigje në pretendimin nr. 3

AK është dashur të i ftojë të gjithë OE pa dallim të ofrojnë mbështetje me dokument zyrtar sa i përket arsyeshmërisë dhe duhet të qëndrojë pas ofertës së saj me çmimin e ofruar duke siguruar AK se në bazë të specifikave do të përmbushet kontrata sipas dosjes së tenderit ku vërtetohet si në vijim (një pjesë e materialit).

Operatori Ekonomik Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., 50000, Gjakovë, ka sjellë sqarimet me datë 08.11.2022.

Me datë 09.11.2022 është mbledhë komisionit e vlerësimit ku bëri shqimin, vlerësimin e dokumenteve të prezantuar nga OE, dhe ishin mjaftueshëm bindëse. Një veprim i njëjtë nuk është bërë edhe me Grupi Operatorëve Ekonomik N.N.P. Euro Construction, Ideor Construction Sh.P.K. apo edhe me OE të tjerë.

4 - Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi -1. Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Pretendimi ankimor nr. 4

Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës - Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 4

Duke qenë se sa i përket këtij pretendimi nga OE, unë si ekspert nuk kam pasur informacione shtesë për të i ofruar përgjigje mbështetëse, ndaj me datën 05.12.2022 ju kam drejtuar me emaili AK- se duke i bashkëngjitur pretendimet ankimore nga OE por përkundër përpjekjeve, ata nuk u përgjigjen konkretisht rreth pretendimit ankimor.

Përmes emailit është përcjellë kërkesa për shpjegime dhe bashkëpunimit në mes AK-së dhe Ekspertit, siç dihet këtë e rregullon LPP-ë duke dhënë shpjegim sepse kjo është në interesin e të dy palëve, si për OE po ashtu edhe për AK. Bashkëpunimin për plotësimin e informacionit e rregullon edhe LPP-ja, Neni 114 Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues. Kërkesë për info shtesë e drejtuar AK me datë 05.12.2022.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "N.P.Sh. "Eltoni Com" & "Pe-Vla-Ku" sh.p.k. dega Kosovë.

Përgjigje në pretendimet ankimore

Pretendimi 1

Nga OE - AK me datën 21.11.2022, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar pretendimet e OE të paraqitura në kërkesën për Rishqyrtim duke mos i trajtuar fare pretendimet por në arsyetimin e vendimit të nxjerr vetëm sipërfaqësisht i trajton si të pa bazuar dy nga pretendimet e OE ndërsa me disa pretendime të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim nuk janë trajtuar dhe arsyetuar

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Në bazë të LPP-së, paragrafit 9 të nenit 108/A ku thuhet: "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Meqenëse kërkesa për rishqyrtim ka edhe pjesë tjera të cilat nga OE është kërkuar që të analizohen në mënyrë që të dëshmohet se ka apo nuk ka shkelje të procedurave gjatë vlerësimit për Operatori Ekonomik "Roza Komani B.I"- Gjakovë, nga AK, mirëpo përveç përgjigjes se OE "N.P.SH. "Eltoni Com" & "PE-VLA-KU" sh.p.k, dega Kosovë sa i përket Çmimit Jo normalisht të ulët dhe autorizimin për nënshkruesin e kontratës , diçka me shumë nuk ka ndonjë përgjigje specifike.

Pretendimi 2

Nga OE konstatimi se trajtimi i kërkesës për rishqyrtim është vonuar me tepër se sa afatet e lejuara (se 6 ditë pas parashtrimit të kërkesës nga ana e OE është trajtuar dhe nxjerr vendimi, ndërsa OE si palë që ka parashtruar kërkesën, nuk është njoftuar për arsyet e shtyrjes se afatit për trajtim të kërkesës.

Përgjigje ne pretendimin nr. 2

Në bazë të LPP-së, paragrafin 6 të nenit 108/A ku thuhet: "Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".

Meqenëse data 15.11.2022 (është në formatin e ankesës dhe e paraqitur në e -prokurimi, AK nuk ka dhënë info tjetër edhe pse është kërkuar përmes emailit, konsiderohet data 15.11.2022 është dita e dorëzimit të ankesës dhe ngarkimit në e -prokurimi. Nisur nga kjo datë , dite e marte prandaj nga dita e mërkurë fillon numërimi (e mërkure, e enjte, e premte dhe e hënë) janë 4 dite pune dhe me

këtë konsiderohet se përgjigjeja nuk është brenda afateve kohore të lejuara bazuar në paragrafin 6 të nenit 108/A.

Meqenëse OE ka bërë ri ngarkimin e ankesës edhe me datë 16.11.2022 por vetëm është e përsëritur prandaj konsiderojë së duhet të merret data 15 atëherë kur është bërë ngarkimi i dokumentit.

Nga raporti i nxjerrë në e prokurimi shifet se ankesa është dorëzuar me datë 15.11.2022 prandaj AK nuk e ka proceduar ankesën brenda afateve kohore sipas LPP- Neni 108/A , paragrafi 6.

Njoftimet

Dosja e tenderit

Ofertat

Sqarimet e DT

Kërkesat për rishqyrtim

Dokumentet - Letrat standarde

Proces verbal, Vendimi B58

Dokumentet lidhur me kontratat

Kërkesat për rishqyrtim

Kërkesë për rishqyrtim

kerkes per rishqyrtim ELTONI.pdf

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

Dokumenti Shtojca

15.11.2022 14:56

Leter stand Jo-normalisht të ulët-Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave-t

Hape:

Shqip

Dokumenti Shtojca

15.11.2022 14:57

Sqarimi sipas Letër standarde e kërkesës -2-Koreben.pdf

Hape:

Shqip

Pretendimi 3

Nga AK OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke marrë vendim për anulimin e OE "Eltoni Com" & "PE-VLA-KU" sh.p.k, dega Kosovë me pretendimin se ju si Grup i Operatoreve Ekonomik nuk jeni me çmim me të ulët nga OE të cilët i keni plotësuar kërkesat e dhëna nga Dosja e Tenderit.

Përgjigje në pretendimin nr 3

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 dhe nenin 61, paragrafin 6, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, adopton Rregullat që plotësojnë dhe japin sqarime për tenderët jo-normalisht e ulët.

OE - Pjesa kryesore ku AK nuk është mbështetur në veprimet e tyre për të e cilësuar si ofertë e cila i plotëson kushtet për të vazhduar me shpërbllim të kontratës kundrejt çmimit me të ulët.

Formati standard i lëshuar nga KRPP për kalkulimin e çmimeve Jo normalisht të Ulëta.

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1		Pranuar 5 oferta		

	kushti 1 - është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar 5 oferta			
2	Stublla, Shpk Groëeco	1	1,358.30	5 - e pesta ne renditje - me e lira
3	Roza Komani	2	271.64	2 - e dyta ne renditje - me e lira
4	Euro Construction Ideor constructio	3	238.80	1 - e para në renditje - me e lira
5	NPSH EltoniCom, PE-VLA-KU	4	492.50	3 - e treta ne renditje - me e lira
6	VB Tofaj	5	993.05	4 - e katërta ne renditje - me e lira
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	3,354.29	
9		mesatarja (C8/3)	670.86	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	prag 30% (mesatarja /1.3)	516.04	ne ketë rast vetëm oferta 3,4 dhe 5 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete

Shpjegim:

Në bazë të rezultateve shifet se OE 3,4 dhe 5 nuk e ka përmbush kushtin dhe si e tillë në këtë rast këto oferta nuk përmbushin kushtin e dytë prandaj nuk vazhdohet me kushtin e tretë.

Pretendimi 4

Nga OE – AK nuk ka ftuar të gjithë operatorët ekonomik për të ofruar dëshmi shtesë por në këtë rast ka bërë shkelje duke e ftuar vetëm OE fitues. Më këtë ka bërë diskriminim për OE të tjerë.

Përgjigje në pretendimin nr. 4

AK është dashur të i ftojë të gjithë OE pa dallim të ofrojnë mbështetje me dokument zyrtar sa i përket arsyeshmërisë dhe duhet të qëndrojë pas ofertës se saj me çmimin e ofruar duke siguruar AK se në bazë të specifikave do të përmbushet kontrata sipas dosjes së tenderit.

Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të ulët.

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 2.1.

ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

Pretendimi 5

Nga OE - AK nuk ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim pas vendimit të AK-së për pezullimin e këtij aktiviteti të prokurimit si:

AK me datë 10.11.2022 ka publikuar njoftimin për shpalljen e fituesit të këtij aktiviteti të prokurimit. OE ankues me datë 15.11.2022 ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimet e njëjta ankimore si në këtë ankesë duke kundërshtuar vendimin – Tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm nga që tenderi juaj nuk me çmimin me të ulet në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

AK ka shqyrtuar kërkesën nga OE me date 21.11.2022 shumë sipërfaqësisht dhe nuk ka ofruar asnjë shpjegim nga kërkesa e OE.

Përgjigje në pretendimin nr. 5

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK nuk ju ka përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

AK nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së, edhe kanë qenë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit,

AK është dashur të marr parasysh nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pretendimi 6

Nga OE "Roza Komani" për prezantimin e faturave të vitit 2021 dhe stokun në njërin anë si dhe prezantimin e stokut zero nga ana tjetër ku AK nuk ka ofruar përgjigje çoftë duke pohuar apo mohuar një gjë të tillë.

Çmimet jo normalisht të ulëta si për pikat e cekura në ankesë, gjithashtu edhe për këtë pjesë nuk ka marrë asnjë përgjigje nga AK ku OE në fjalë ka dyshimet e veta të cilat janë të prezantuara me vlera të ulëta nga OE fitues.

Lista e stafit të prezantuar ku në ndër tjera shifet se ka page minimale e cila është nën pagën minimale të lejuar në Republikën e Kosovës.

Prezantimi i punëtorëve në listë duke paraqitur konflikt interesi siq është rasti me menaxherin e kontratës Ndue Komani e që i njëjti nuk ka autorizim për nënshkrimin e deklaratës nën betim, të njëjtën e ka demantuar AK duke thënë se nuk është kërkuar në dosjen e tenderit, nga eksperti nuk është parë se kërkohet një gjë e tillë.

Listën e punëtorëve të OE të rekomanduar për kontratë gjinden edhe punëtor të deklaruar e të cilët kanë konflikt interesi apo ndikim në vendim marrje e që në rastin konkret është konflikt i pastër interesi në dukje sepse i njëti merr pagë si asamblist i Komunës së Gjakovës por edhe operatori i rekomanduar për kontratë, fakt që vërtetohet përmes listës së punëtorëve të OE të shpallur fitues nga AK Komuna e Gjakovës.

Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës - Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues). Sipas OE ky kriter nuk është i plotësuar nga OE fitues i shpallur nga AK Gjakovë.

Përgjigje në pretendimin nr. 6 (pikat a,b,c,d,e dhe f) Duke qenë se sa i përket këtyre pretendimeve nga OE, unë si ekspert nuk kam pasur informacione shtesë për të i ofruar përgjigje mbështetëse, ndaj me datën 05.12.2022 ju kam drejtuar me email AK-së duke i bashkëngjitur pretendimet ankimore nga OE, por përkundër përpjekjeve, ata nuk u përgjigjen konkretisht se cka është kërkuar përveç bashkëngjitjes së 4 dokumenteve ku dy veç i kisha edhe me pare ndërsa dy të pranuar janë trajtuar në këtë ekspertizë siq janë : Letra Standarde e kërkesës për çmime Jo normalisht të ulëta si dhe përgjigjen nga OE fitues "Roza Komani" dërguar AK me datë 04.11.2022.

Përmes emailit është përcjellë Ofrimi i shpjegimeve dhe bashkëpunimit në mes AK-së dhe Ekspertit, siq dihet këtë e rregullon LPP duke dhënë shpjegim sepse kjo është në interesin e të dy palëve, si për OE po ashtu edhe për AK.

Bashkëpunimin për plotësimin e informacionit e rregullon edhe LPP-Neni 114 Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues.

Kërkese për info shtesë e drejtuar AK me datë 05.12.2022

remzi llumnica
To: Desim Haxhiu: faton.gutaj@rks-gov.net
Pyetje- AK.docx

05/12/2022 10:00

Pershendetje
Jam Eksperti i caktuar nga OSHP me numër të autorizimit 715-717-226.

Duke qene se jeni dy ankesesa i perket projektit Rregullime dhe mirëmbajtje te shkollave, Nr i Prokurimit
atohere

631-22-9759-5-2-1

Mbashtetur ne LIGJIN NR. 03/L-032

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-068

Duhet te i trajtojme ne formen me te drejte te mundehme ankesat e OE . prandaj per te arritur deri te nje perfundim sa me te drejte me duhet te i pranoje nga ana juaj pyetjet dhe dokumentet e kerkura siq jane te bashengjitura ne atach.

Ju lus qe sot gjate dites me duhet te i pranoje nga ana juaj ne forme shume te qarte dhe pambajtesore per te gjitha qeshtjet e ngritura vec e vec ne menyre qe ekspertize te prezantohet drejte, qarte, e prane shume dhe bindese edhe per palat tjera.

Nje dokument te cilin e kam kerkuar nga ana juaj me date 02.12.2022 nuk e kam pranuar prandaj me eshte dachtur te hulumtoje rrege tjera e qe sa i perket emailit te dates 05.12.2022 kerkoja qe te me pergjigjeni shpejt, sakt me deshmte mbashtetese.

Une te mbare

Nisur nga aspekti rregullativ i LPP-se, kam ofruar shpjegime se në cilat pika ka bërë shkelje AK dhe anashkalim të zbatimit të LPP-se me informatat që disponoja.

Diskriminimi i Operatoreve dhe mos aplikimi i LPP-së, Neni 7-Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nga AK.

Operatori Ekonomik "Roza Komani B.I." me seli në Gjakovë, ka sjell sqarimet me datë 08.11.2022.

Me datë 09.11.2022 është mbledh komisionit e vlerësimit ku bëri shqimin, vlersimin e dokumenteve të prezantuar nga OE ,dhe ishin mjaftueshëm bindëse.

Një veprim i njëjtë nuk është bërë edhe me Grupin Operatorëve Ekonomik N.N.P. N.P.SH. "Eltoni Com" & "PE-VLA-KU" SHPK, dega Kosovë apo edhe me OE të tjerë.

AK përmes Letrës Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo normalisht të ulet me datë 02.11.2022 është drejtuar OE fitues për shpjegime sipas pikave:

Kalkulimin e detajuar të shpenzimeve,

Pro fature ose dokument të mundësisë së furnizimit në fjalë (me të gjitha taksat/tatimet)

Kalkulimin e e fitimit.

Në dosjen e tenderit tuaj të paraqitur kemi vërejtur se çmimet e paraqitura në disa pozicione janë ca të ulëta, në pozicionet e cekura si me poshtë,

Ndërtimi i dritareve dhe dyerve nga PVC profilet pozicionet:2.2

Ndërtimi dyerve në dhoma mësimi -pozicionet:5.2,5.3,5.4,5.9

Punët e muratimit-pozicionet: 9.1.9.3. (siq shifet ne vijim)



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët

Gjakovë 02.11.2022

Komuna e Gjakovës, Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit)

Roza Komani B.I., Rr. Dometik Pergeja p.n., 56000, Gjakovë

Nr. i prokurimit:	632-22-9759-S-2-1
Nr. i brendshëm	632-22-102-S-2-1

Titulli: Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave
I ndërruar Z.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Në konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Në dosjen e tenderit tuaj të paraqitur kemi vërejtur se çmimet e paraqitura në disa pozicione janë ca të ulëta, ca të larta në pozicionet e cekura si më poshtë:

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detaj se ku jeni bazuar në çmimet e ofruara për pozicionet e më poshtme.

Kërkojmë nga Operatori Ekonomik që të dorëzojë me shkrim një deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur duke zhërrthyer në mënyrë të detajuar kalkulimin e çmimit të paraqitur. Si dëshmi duhet të paraqitet për secilin pozicion të më poshtëm.

- Kalkulimin e detajuar të shpenzimeve
- Profaturë ose dokument të mundësisë së furnizimit në fjalë (me të gjitha taksat/tatimet)
- Kalkulimin e fitimit.

Në dosjen e tenderit tuaj të paraqitur kemi vërejtur se çmimet e paraqitura në disa pozicione janë ca të ulëta, në pozicionet e cekura si më poshtë:

Gjeni të bashkëngjitur në vijim përgjigjen nga OE "Roza Komani B.I".

Data: 04/11/2022

Nga: ROZA KOMANI B.I (NNSH Korben)

Për: KK GJAKOVË, Departamenti I Prokurimit

Lënda: Sqarim në lidhje me Letren standard të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalishtë të ulët për: Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave me nr prokurimi: 632-22-9759-5-2-1

Të nderuar, pasi kemi analizuar pikat e juaja në letren standard për informata mbi tenderët jo-normalishtë të ulët, japim këtë përgjigje si në vijim:

Deklarojmë se qmimet e vendosura në paramas përfshijnë të gjitha shpenzimet e parapara për realizim të projektit. Këtu duke përfshirë edhe të gjitha taksat, si dhe të gjitha shpenzimet të stafit tekniko-profesional. Duke mos lënë anash edhe fitimin e mundshëm. Kuptohet se asnjë kompani nuk synon të marrë punë të cilat rezultojnë me humbje. Ne pasi kemi analizuar në mënyrë detale të gjitha pozicionet e parapara në paramasë, dhe të njëjtat kemi dalë në terren të kontrollojmë. Duke patur më të qartë në këtë mënyrë se si të realizojmë punën në mënyrë më efektive. Që rezultati të jetë për të dyja anët pozitiv.

Mund të ju duket në disa pika qmimi pak më i ulët. Por ne deklarojmë se produktet të cilat ne nuk i kemi në dispozicion, kemi ofertë për to nga Kompanitë me të cilat bashkëpunojmë, me një qmim të volitshëm. Gjithëashtu në disa pozicione qmimi është më i lartë. Por garantojmë me përgjegjësi të plotë se qmimi final përfshin edhe një fitim neto për kompaninë.

Më poshtë kemi paraqitur llogarritjet të asnjë se si kemi kalkuluar shpenzimet dhe fitimet për këtë projekt. Gjithëashtu kësaj shkrese ne kemi bashkëngjitur edhe ofertat tona me bashkëpunëtorët tonë.

Gjithëashtu theksojmë se disa pozicione ne mund të realizojmë me paisje tona. Dhe nuk kemi nevojë për ofertë apo profaturë të ndonjë kompanie. Pozicione këto si Demolime të ndryshme, bartje të mbeturinave, punimet të ndryshme, pasirime të sipërfaqeve, punët përgaditore dhe gërmimet dheut etj dhe hartime të projekteve. Mund të realizojmë me një kosto më të ulët pasi që kemi stafin adekuat dhe paisjet tona.

Andaj ne qëndrojmë prapa qmimeve të ofruara për arsye i kemi të kalkuluar në detale shpenzimet dhe fitimet bazuar në qmime të fitimit, të cilat i kemi siguruar nga kompanitë furnizuese me faura, oferta dhe profitura, para ofertimit të tenderit në fjalë.

Me respekt dhe nderime

Roza Komani B.I
(NNSH Korben)

• 811129726 •

Me datë 01.11.2022 OE fitues "Roza Komani B.I" kthen përgjigje me shkrim duke i bashkëngjitur edhe shpjegimet e tyre sa i përket :

Kalkulimin e detajuar të shpenzimeve,

Pro faturë ose dokument të mundësisë së furnizimit në fjalë (me të gjitha taksat/tatimet)

Kalkulimin e e fitimit.

Kalkulimi është bërë duke shtuar edhe pjesën e kalkulimit për secilin pozicion dhe duke bashkëngjitur faturë furnizimi.

Ndërtimi i dritareve dhe dyerve nga PVC profilet pozicionet:2.2

(është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë të furnizimit shtuar edhe pjesën e montimit)

Ndërtimi dyerve në dhoma mësimi -pozicionet:5.2,5.3,5.4,5.9

Pozicioni 5.2 - (është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë të furnizimit shtuar edhe pjesën e shpenzimeve)

Pozicioni 5.3 - (është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë të furnizimit shtuar edhe pjesën e shpenzimeve),

Pozicioni 5.4 - (është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë por fatura e dëshmuar është e vitit 2021),

Pozicioni 5.9 - (është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë por fatura e dëshmuar është e vitit 2021),

Pozicioni 9.1 - (është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë por fatura e dëshmuar për bllok është e vitit 2021),

Pozicioni 9.3 - (është bërë kalkulimi dhe është mbështetur edhe me faturë të furnizimit shtuar edhe pjesën e shpenzimeve).

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në:

Ligji Nr. 05/L-092 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe Plotësuar Me Ligjin Nr. 05/L-068

Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenciale të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Mbështetur në nenet dhe pikat e më sipërme ekspert i propozon

Meqenëse janë analizuar të gjitha dokumentet dhe pretendimet ankimore të cilat i shtjelluar me lartë, Autoriteti Kontraktues me veprimet/mosveprimet e tyre, nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik duke cenuar dhe mos mbrojtur edhe paratë publike.

Prandaj, rekomandojmë Panelin Shqyrtues i OSHP-se, që sipas detyrës zyrtare dhe kompetencave të saj, të autorizuar sipas ligjit:

- Të aprovojë si të bazuar ankesat nga OE N.N.P. "Euro Construction" & "Ideor Construction" Sh.P.K.; si dhe ankesën nga OE N.P.SH. "Eltoni Com" & "PE-VLA-KU" SHPK.
- Ta shfuqizojë B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarte lidhur me aktivitetin e prokurimit njoftimin e AK-se për shpallje të fituesit, dhe
- Të kthejë lenden në Rivlerësim ngase gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Neni 1 – Qëllimi - 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimeve dhe analizimit të provave në tërësi sqaron, :

Përgjigje në pretendimet ankimore të GOE ankues "N.P.Sh. "Eltoni Com" & "Pe-Vla-Ku" sh.p.k, dega Kosovë.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga GOE ankues Paneli Shqyrtues konstaton se në trajtimin e kësaj ankese do të ndalet tek prishja e marrëveshjes së konzorciumit në mes grupit të operatorëve ekonomik "NPSH Eltoni Com" & "Pe-Vla-Ku" Sh.P.K si pikë kyçe e cila përcakton rrjedhën e vendim-marrjes përfundimtare, andaj PSH me marrjen e njoftimit me shkrim nga AK lidhur me tërheqjen nga grupi i konzorciumit nga njëri anëtar "Pe-Vla-Ku" Sh.P.K i cili po ashtu këtë njoftim e kishte ngarkuar edhe në platformën elektronike E-Prokurimi duke bërë të ditur largimin e tij përfundimisht nga ky aktivitet i prokurimit dhe nga kjo marrëveshje PSH konstaton se duke u bazuar në dispozitat ligjore nga RRUOP e nenit 27.5, se grupi i OE nuk ka mundësi ligjore të të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë ky ndryshim/ tërheqje atëherë ky ofertues do të refuzohet, andaj PSH nuk e konsideron të nevojshme që pretendimet tjera lidhur me këta OE të shqyrtohen më tutje për faktin se tanimë kemi të qartë klasifikimin përfundimtar në relacion me vet këtë GOE ankues dhe se kjo pikë për këtë aktivitet prokurimi nga Paneli Shqyrtues konsiderohet si pikë përcaktuese.

Përgjigje në pretendimet ankimore të GOE ankues "Euro Construction - Ideor Construction sh.p.k-Rahovec".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga GOE ankues Paneli Shqyrtues konstaton se në trajtimin e kësaj ankese do të ndalet tek pretendimi i parë ankimor ku GOE ankues pretendon se gjatë ngarkimit të ofertës është harruar të ngarkohet edhe lista e stafit nga partneri i grupit kompania "Euro Construction", PSH konstaton se njëra nga kërkesat e dosjes konkretisht tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qenë edhe Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit, PSH bazuar në faktet e pranuar nga operatori ekonomik shihet se lista e stafit "Idcor Construction" është dorëzuar përmes dosjes dhe i ka 12 punëtorë dhe si numër i dorëzuar i këtyre punonjësve nuk plotëson kërkesën e DT -së dhe si e tillë pasi është kërkesë kualifikuese GOE ankues nga PSH vlerësohet si i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të GOE ankues "Euro Construction - Ideor Construction sh.p.k-Rahovec" ndaj OE të rekomanduar :

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga GOE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit , PSH do të ndalet tek pretendimi kyq i cili e përcakton rrjedhën e vendimmarrjes sa i përket këtij aktiviteti, andaj lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar sa i përket -Vërtetimit nga Administrata Tatimore e Kosovës - Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues), PSH konstaton se edhe pse ky vërtetim është kërkuar për OE fitues, PSH i është drejtuar me pyetje konkrete AK- së e cila është obliguar që t'ia dëshmoj panelit shqyrtues vërtetësinë e dokumentacionit sipas këtij pretendimi të ngritur nga GOE ankues dhe se këto dëshmi PSH i ka pranuar përmes email-it nga AK, të cilat dëshmojnë se OE i rekomanduar për kontratë ka të lëshuar Vërtetimin Tatimor i datës 23.09.2022 si dhe Vërtetimin nga Gjykata Komerciale me nr Agj. Nr.318/22 i datës 16.08.2022 , që të dëshmitë e dorëzuara nga ana e AK në emër të OE-të rekomanduar janë të lëshuara nga organet kompetente para datës së hapjes së tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit vlerëson se AK gjatë procedurës së vlersimit ka respektuar dispozitat ligjore të nenit 7 dhe nenit 59, të LPP-së.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetaria e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi Komunal Gjakovë

1x1 OE-ve ankese.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Besim Haxhija

From: Besim Haxhija
Sent: Monday, February 6, 2023 9:32 AM
To: 'Kimete.Z.Gashi@rks-gov.net'
Cc: Faton Gutaj
Subject: FW: 715-717-22

Konfirmim:

Ju falënderojmë për sqarimin lidhur me Aktvendimin tuaj nr.715-717-22

Me respekt
Besim Haxhija
Zyra e Prokurimit
KK Gjakove

From: Kimete Z. Gashi <Kimete.Z.Gashi@rks-gov.net>
Sent: Monday, February 6, 2023 8:08 AM
To: Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>; Besim Haxhija <besim.haxhija@rks-gov.net>
Subject: 715-717-22

Pershendetje,

Te premten keni pranuar Vendimin me nr. prot 715-717-22 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi dhe mirembajtja e shkollave" te iniciuar nga ju si autoritet kontraktues,

Ne kete vendim te dates 03.02.2023 nga paneli eshte vendosur qe te Mbetet ne fuqi vendimi i AK , vetem se eshte leshuar nje gabim teknik ne piken e dispozitivit te ketij vendimi ku shenon se .., kthehet ne rivleresim , pra pjesa kthehet ne rivleresim eshte leshuar si gabim teknik dhe si e till nuk merret parasys,

Andaj , sipas te cekurave si me larte pika e dyte e dispozitivit duhet te jete :

II. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 10.11.2022, për aktivitetin e prokurimit, "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave" me nr. të prokurimit: 632-22-9759-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal Gjakovë.

Kimete GASHI
Anëtar Bordi
Organi Shqyrtues i Prokurimit